



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0483

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim, Kryesuese, Kimete Gashi- Brajshori dhe Vedat Poterqoi -Anëtar duke vendosur sipas ankesës së OE Bahri Asllani, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri” me numër të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, më 20/08/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e Bahri Asllani me nr. 2024/0483 , e datës 06/06/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri”, me numër të prokurimit 616-23-4210-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës., lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.05.2023 Komuna e Prishtinës., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri” me numër të prokurimit 616-23-4210-5-1-1.

Me 01.12.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë GOE; Tsr Shpk, Idk Konstruksion ShPK.

Me 22.05.2024, OE "Bahri Asllani., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 28.05.2024.

Me 02.06.2024, OE Bahri Asllani., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 483/24, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Bahri Asllani., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i pare (I) : “ Neve si OE na bën te papërgjegjshëm nga Drejtori i Zyrës se Prokurimit por jo nga komisioni vlerësues është i paqëndrueshëm. Sipas kërkesës së Dosjes se tenderit: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Pika 9.1 & 9.2 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te kësaj natyre, sinjalizim rrugorë, semafora, matësve të shpejtësive apo të ngjashme me vlerë minimale prej 1,200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit. Ne kemi plotësuar kërkesën e mësipërme përmes listës se ofruar ne dosjen e ofertës tone. Listën e projekteve te realizuara nga EKOINVEST ne gjuhen shqipe (Prova nr. 1) dhe Listën e projekteve te realizuara nga partneri ynë ne kozorcium La Semaforica ne gjuhen angleze (Prova 2). Siç shihet, vlera totale e këtyre projekteve është 2,845,210.38 Euro. Kjo siç shihet e tejkalon substancialisht kërkesën e dosjes se tenderit prej 1,200,000.00 Euro. Është dashur te veprohet konform Udhëzues Nr. 001/2023 Për Prokurimin Publik, nenit 10.1 Sqarimi i tenderëve

gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së. Këtu shihet qarte veprimet e njëanshme të Zyrtarit të lartë të Prokurimit të AK i cili në mënyrë arbitrare ka vepruar në kundërshtim me raportin e komisionit të vlerësimit teknik. Në ankese është i bashkangjitur raporti i vlerësimit. LISTA e plotë standarde për përshtatshmërinë e aftësive profesionale të tenderëve.”

Pretendimi i dytë (II) : “ Në si GOE nuk kemi plotësuar kërkesën si me poshtë të DT: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Pika 9.1 & 9.2 OE duhet të ketë Baze për Prodhimin e betonit në Pronësi apo marrvëshje përfurnizim me beton Kopja e licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur OE ka marrvëshje për furnizim, OE duhet të dorëzojë edhe kopjen e marrvëshjes përfurnizim. Ky pretendim është i pa qëndrueshëm pasi që në këtë kërkesë të DT e kemi plotësuar (dëshmia nr. 3). Aplikimin sipas procedurave zyrtare të rregulluar nga KPMM për vazhdimin e licencës është bërë para kohës së hapjes së tenderit siq e parasheh ligji dhe ky vazhdim i licencimit është në proces. Si pasoje e mungesës së bordit të organit përgjegjës për vazhdimin e licencave (Komisioni i Pavarur për Minerale dhe Minerale -KPMM) kjo kërkesë është në proces. Në mbështetje të qasjes fundamentale të zbatimit të ligjit që ndërlihet me prezumimin, mjafton të shikohet Ligji Nr. 04/L-202 Për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, konkretisht Neni 11- Veprimet Administrative për Licenca Profesionale paragrafët 2 dhe 3, citat: "2. Mbajtësi i licencës profesionale do të nënshtrohet kërkesave disiplinore dhe etike të miratuara nga bordi i licencimit. 3. Asnjë mbajtës i licencës profesionale nuk mund të privohet nga licenca e tillë, përveç siç parashihet siç parashihet me rregulla dhe procedura të qarta dhe transparente që janë bërë publike paraprakisht". Po ashtu, ligjvënësi në mënyrë shumë efektive dhe me delikatesë ka paraparë edhe situata të ndryshme siç ceket në Nenin 28 të Ligji Nr. 04/L-202 Për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, në të cilin thekson, citat: "Nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe, për procedurën për leje dhe licenca, zbatohen dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative". Për më tepër lidhur me afatin, Neni 98 - Afati për përfundimin e procedurës administrative, paragrafi 2 dhe 3 theksojnë, citat: "2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj; Paragrafi 3. "Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës përfillimin e procedurës, afati i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të fillojë të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës". Andaj, në këtë rast, duke u bazuar në faktin se Furnizuesi i Betonit Titan, ka pasur licencë dhe ka plotësuar të gjitha kriteret (mjafton të shikohet neni 11 i Ligjit Nr. 04/L-202 Për Sistemin e Lejeve dhe Licencave) dhe po i njëjti ka aplikuar për licencë shumë kohë më parë, rrjedhimisht duke u bazuar në nenin 28 të Ligji Nr. 04/L-202 Për Sistemin E Lejeve Dhe Licencave, bazuar në Ligjit Nr. 05/L - 031, konkretisht në nenin 98 - Afati për përfundimin e procedurës administrative (paragrafi 2 dhe 3) dhe në veçanti

në nenin 100 - Akti administrativ i miratuar në heshtje, përmbajnë të gjitha elementet juridike që Furnizuesi i betonit Titan ka licencë valide e cila edhe vërtetohet përmes furnizimeve të tij të përditshme ne institucione kredibile duke përfshirë edhe KFOR-in (shih prova të faturimeve - Dëshmi 4). Për me tepër, Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje flagrante te LPP-se duke e rekomanduar për kontrate një GOE te papërgjegjshëm, papërgjegjshmëria teknike e te cilit është e prezantuar me poshtë: Shkelja 1: Ne FTD pika 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar : Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Autorizimin origjinal nga prodhuesi apo distributor i autorizuar për softvare i cili duhet të jetë kompatibil me nyjet seuaforike ekzistuese për vëzhgim online.. Kopja e Autorizimit te prodhuesit apo distributorit te Autorizuar. Nuk ka autorizim nga prodhuesi i produkteve ekzistuese ose distributori qe do te mbulonte këtë kërkesë për vëzhgim online. GOE i rekomanduar për kontratë në katalogun e tyre të SCAE Spa, ka prezantuar Software SMTWEB - Remote Traffic Monitoring System, në te cilin shkruan se është kompatibil me kontrollorët VEGA/PEGASO/DRIONE, te prodhuara nga vete SCAE Spa. (Shkëputur ngafq. 17,8 dëshmitë e SPECifikave TEKNIKE_001-060 e ofertes se GOE te rekomanduar). Ky softwear sipas dokumentacionit te lartë cekur shihet te jete kompatibil vetëm me Kontrolleret e prodhuesit SCAE por jo edhe me kontroller të prodhuesit ekzistues LaSemaforica. Shkelja 2: Në Specifikimin Teknik është kërkuar: (Faqe 8, Annex 1, Specifikimet Teknike) Kërkesa, Oferta: Karakteristikat teknike te kontrollerit: Tipi 1 pllakave: Eurocard (100mm x 160 mm) me konektor sipas DIN 41612. Nuk e përmbush kete kerkese GOE i rekomanduar për kontrate e ka ofruar kontrollerin e prodhuesit SCAE, tipi VEGA. Pllakat e këtij kontrolleri nuk është dëshmuar me dokumentacion se i kane këto dimensione dhe e përmbushin këtë standard. Te njëjtat nuk mund te motohen fizikisht ne kontrollerin ekzistuese. Shkelja 3: Ne Specifikimin Teknik është kërkuar: Në faqe 8, Karakteristikat teknike te kontrollerit, Annex 1-Specifikimet Teknike: Kërkesa Certifikatat e atesteve (duhet te dorëzohen me oferte) EN 12675 EN-50566, EN-50293, EN:50556:2011-02, EN 600868-2-64, CEI 214-9 (2002-04) HD638S 1 (2001-01) GOE ka dështuar në plotësimin e kësaj kërkesë pasi qe ne ofertën e tij ka dorëzuar certifikatat EN të prodhuesit Tamburrini Alessandro (i cili është prodhues i shenjave te rrugës) (Prova 5) ndërsa nuk është ofruar asnjë certifikatë - standard e prodhuesit "S.C.A.E" s.p.a (prodhuesi i kontrollerit) me te cilin GOE ka ofertuar. Shkelja 4: 1. Në Specifikimin Teknik është kërkuar: Në faqe 7, Annex 1-Specifikimet Teknike: Pajisje Semaforike Smart ose ekuivalente dhe Moster për pozicionin 34 se bashku me oferte (pika 9.1 & 9.2 ne FDT-Dorëzimi i mostrave). GOE edhe ne këtë rast ka dështuar te plotësoj kërkesën ne fjale pasi qe nuk ka dorëzuar moster sipas kërkesës Llatern Smart Polikarbonat ose aliumin me kamera te integruar. GOE i rekomanduar, për moster ka dorëzuar vetëm një kamere te thjeshte s(foto me poshtë foto mostra e ofruar për këtë kërkesë). Mostra e ofruar nga GEO nuk plotëson ne asnjë pike kerkesen e DT. Shkelja 5: Në faqe 7, Annex 1-Specifikimet Teknike. Është kërkuar: Led Markerat Me Kontroller me karakteristikat: Maksimum 4mm mbi sipërfaqen e tokës, Furnizim me energji 24 VDC, 12 copa LED, Rezistenca mekanike deri ne 160 ton, Diameter 144 mm, Prej çeliku inox, Rezistent ndaj pastrimit te bores dhe gërvishtjeve. Pika 9.1 & 9.2 ne DT-Dorëzimi i mostrave - Pozicioni 69) së bashku me ofertë: Furnizimi, transporti dhe montimi i LED markerit (K37) me karakteristika minimale ose e avancuar: E bardhë e dyanshme, ndriçimi i lartë dhe intensiteti i dritës, rezistent

ndaj dritës fantazmë, diametër 144 mm, maksimum 4 mm mbl sipërfaqen e rrugës, furnizimi me energji 24 VDC, konsumi 2.88 W, intensiteti i dritës 75 cd, 12 copa LED 5 mm, kendi i shikimit 15*, temperatura e ambientit -25 *C deri ne 85 *C shkalla e mbrojtjes IP68, IKIO mundësia e kontrollit të dritës - ndriçimi i rregullueshëm, ndërlydhja e burimeve të dritës për kompensimin automatik të dritës në rast të dështimit të LED-ve individuale, pjesa e sipërme e kutisë është prej çeliku inox rezistent ndaj pa strimit të borës dhe gërvishtjeve, pjesa e poshtme e kabinës është bërë prej alumini, rezistent ndaj ujit të kripur, nivele mbrojtjeje IP68. rezistenca mekanike deri ne 160 ton. GOE i rekomanduar për kontrate ka dështuar në tërësi të përmbush kërkesën e kësaj kërkesë të DT. Mostra e ofruar nga GOE i rekomanduar për kontrate nuk ka të bëjë me kërkesën duke mos plotësuar as edhe një pikë të Specifikimit Teknik. Mostra e dorëzuar nga GOE në fjalë: Bazuar në datashet të produktit të dorëzuar i cili gjendet në web-faqe të prodhuesit (<https://www.scae.net/en/products/road-markers/#solartop24>), shihet qarte. Nga tabela e bashkangjitur ankesa, shihet qarte se GOE i rekomanduar për kontrate nuk i plotëson kriteret dhe kushtet nga Dosja e Tenderit dhe Specifikimi Teknik, rrjedhimisht është ofertues i papërgjegjshëm. Shkelja 6: Në Specifikimin Teknik është kërkuar: Në faqe 6, Annex 1-SPECIFIKIMET TEKNIKE: Përshkrimi Teknik i semaforeve (laternave), Mostër për pozicionin 31 së bashku me ofertë (pika 9.1 & 9.2 në FDT-Dorëzimi i mostrave). Pozicioni 31: “Furnizimi, transporti i treguesi (laterik) tre ngjyrësh për automjete 0 300x3 i teknologjisë Power LED, sipas standardeve EU. EN-12368. GOE i rekomanduar për kontrate ka dështuar në plotësimin e kësaj kërkesë pasi që mostra e dorëzuar nuk e plotëson kërkesën. Në vend të llaternes 3 pjesësh me diametër 300 mm (kërkesafi300x3) ka dorëzuar llaterne të përbërë: 1 pjesë 300mm dhe 2 pjesë 200 mm. Për qëllim krahasimi, paraqesim me poshtë dallimin mes kërkesës së AK dhe ofertës së GOE të rekomanduar. Abuzimi me pyetje sqaruese, diskriminimi dhe pa barazia. AK duke abuzuar shkajshmërisht me të drejtat që i jep nën 72 të LPP-së kërkon sqarime nga GOE i rekomanduar për kontratë në njëmbëdhjetë (11) pika, ndërsa neve nuk na kërkohet as edhe një sqarim i vetëm nga ana e AK. Kjo paraqet diskriminim dhe jo barazi nga AK, rrjedhimisht shkelje flagrante të nenit 7 të LPP-së dhe abuzim i nenit 72 të LPP-së si dhe shkelje evidente të nenit 38.2 dhe 40.4 të RRPP nr. 001-2022 dhe paraqiten edhe nuancat e keqpërdorimit të drejtave dhe detyrave zyrtare. AK edhe në vendimin mbi refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, në mënyrë krejtësisht jo ligjore mundohet që veprimet veta të arsyetojë në bazë të nenit 72 të LPP-së dhe nenin 24 të RRPP- së, me të cilat veprime përmes pyetjeve sqaruese AK tenton që të kamuflojë papërgjegjshmërinë teknike të GEO të rekomanduar për kontratë. Të njëjtit i mundësohet që për dosjen e tenderit në fjalë të kërkohen sqarime për 11 pika dhe pothuajse të rigjenerohet gjysma e dosjes të tenderit. Pikërisht me anë të këtyre 11 pyetjeve i mundësohet që GOE të bën plotësim material. Rrjedhimisht, është e papranueshme, befasuese dhe mjaft shqetësuese se si mund të pranohen arsyetimet e GOE (të rekomanduar për kontratë), përgjigjet e të cilat reflektojnë të pavërteta dhe pikërisht me këto të pavërteta dhe në kundërshtim me rekomandimin e dy anëtarëve të komisionit të ri vlerësimit GOE i papërgjegjshëm rekomandohet për kontratë. Këto veprime nuk janë në përputhshmëri me nenin 38 pika 38.3 të sqarimit i tenderëve në Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurim Publik, i cili në mënyrë të precizuar thekson, citat: "Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet" dhe pika 38.4 në të cilin theksohet se Autoriteti Kontraktues do të sigurojë

mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik. Kjo gjithashtu është e ndaluar edhe me nenin 40.4 të Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurim Publik.”

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: Operatori ekonomik "Bahri Asllani B.I. — NTSH Ekoinvest" (tutje "parashtruesi") me datë 22.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për Siguri" me nr. të prokurimit 616-23-4210-5-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meritum) të kërkesës. Pretendimet ankimore të parashtruesit janë se tenderuesi i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesat teknike dhe profesionale të dosjes Së tenderit dhe/ apo specifikat teknike prandaj ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit për arsye të cilat i gjeni të bashkangjitura në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim. Nga analizimi i kërkesës Për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar. Pra në asnjë moment parashtruesi nuk i ka kontestuar të gjeturat e komisionit vlerësues sipas të cilave vet parashtruesi është tenderues i papërgjegjshëm. Rrjedhimisht i njëjti është pajtuar me konstatimin e autoritetit kontraktues sipas të cilit parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Me fjalë të tjera nuk është fare kontestues fakti se parashtruesi ka dorëzuar kopjes e lejës Për aktivitete të veçanta me nr. 633/ KPMM/ 2018 e Cila është me validitet të skaduar me datë 12.09.2023, pavarësisht faktit që me dosjen e tenderit është kërkuar specifikisht që licenca të jetë me validitet. Ngjashëm vlen edhe sa i përket faktit që parashtruesi ka dorëzuar kontrata dhe dokumente sipas aneksit 6 të DT në gjuhën italiane që është në kundërshtim me nenin 13 par. 4 të LPP. Duke qenë vet ofertues i papërgjegjshëm, parashtruesi nuk ka arritur që të dëshmojë asnjë interes material nga cilido rezultat i këtij aktiviteti të prokurimit. Prandaj parashtruesi nuk ka arritur që të argumentoj se është palë e interesuar në raport me pretendimet e veta ankimore sipas kërkesës Për rishqyrtim. Për termin "palë e interesuar" duhet cituar nenin 4 par. 1 nën par. 26 të LPP përmes të cilit përcaktohet se " Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike Ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë Ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një Shkelje e pretenduar". Vlen të shtohet po ashtu çmimi i ofertuar nga parashtruesi është rreth 26,000.00 euro më i lartë sesa çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar. Pra jo vetëm se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme (fakt i pa kontestuar në kërkesën Për rishqyrtim) Për çka nuk është fare palë e interesuar në raport me kërkesën e vet Për rishqyrtim, por edhe çmimi me të cilin ka ofertuar parashtruesi është dukshëm më i lartë sesa çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar. Sa i përket pjesës në kërkesën Për rishqyrtim ku aludohet se komisioni vlerësues nuk ka pasur të drejtë që të kërkojë sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar, duhet cekur se sqarimet shtesë janë manifestuar në përputhje të plotë me nenin 72 të LPP lidhur me nenin 24 të RRPP. Në fund por jo Për nga rëndësia, duhet

sqaruar se tenderuesi i rekomanduar gjatë kësaj procedure të prokurimit ka parashtruar ankesë në OSHP. Me këtë rast paneli shqyrtues me datë 05.09.2023 ka nxjerrë vendimin OSHP:2023/0410 përmes të cilit miratuar pjesërisht ankesën e tenderuesit të rekomanduar. Rrjedhimisht raporti vlerësues por edhe njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues është në përputhje të plotë edhe me vendimin OSHP:2023/ 0410. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme Për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa Për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nën paragrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nën paragrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/ 2022 Për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Bahri Asllani eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/483 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: “Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës punë vlera e parashikuar 800,000.00€. AK me dt. 10.05.2023 ka publikuar Njoftimin për kontratë, korigjimin e fundit të procedurës përmes formularit standard e ka bërë me dt. 18.09.2023 ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 10.10.2023 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar tre operator ekonomik në mesin e tyre edhe OE ankues AK- Kuvendi Komunal Prishtinë me dt.17.05.2024 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku për kontratë ka rekomanduar grupin e OE-ve “ Tsr Shpk, Idk Konstruktion Shpk në vlerë 767,075.00€. Ndërsa ofertën e OE ankues komisioni i vlerësimit e ka vlerësuar si të papërgjegjshme. Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt.22.05.2024 brenda afatit ligjor. AK me dt.28.05.2024

nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pabazuar. Vlen të ceket fakti se AK në vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ka arsyetuar vendimin për secilin pretendimin ankimor të OE ankues. OE i pakënaqur me përgjigjen e AK-së me dt.06.06.2024 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime ankimore te njëjta.”

Konstatimi i pare: “Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se parashtruesi i ankesës në kërkesën për Ri-shqyrtim dhe ankesën e dorëzuar në OSHP, fillimisht kundërshton vendimin e AK sa i parkete grupit të OE të rekomanduar për kontratë, si dhe ka parashtruar pretendime ankimore se oferta e dorëzuar nga OE ankues është e përgjegjshme. Vlen të ceket fakti se oferta e OE ankues është më e shtrenjtë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë me një diferencë prej 25,813.00€. Eksperti Shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin e pare te OE ankues. AK gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit tek përshtatshmëria teknike dhe profesionale kishte paraparë Kërkesën lidhur për kontratat e realizuara si në vijim; Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te kësaj natyre, sinjalizim rrugorë, semafora, matësve të shpejtësive apo të ngjashme me vlerë minimale prej 1,200,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit. Dëshmia e kërkuar; Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e punëve OE- Ankues për të përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit me ofertë ka dorëzuar tek folderi i renditur me nr. 2 dorëzimi i tenderit në faqe 52 një listë të kontratave të realizuara nga natyra e kontratës nga anëtari i konzerciumit EKO INVEST me gjithsej 6 projekte te realizuara me vlerë totale prej 1,091,689.9€. Nëse i referohemi kërkesës së dosjes së tenderit, ku është kërkuar që OE të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre në tri vitet e fundit, atëherë mund të konstatohet se projekte te përfunduara të prezantuara në listën e kontratave nga ana e OE ankues, që i përkasin natyrës së kontratës dhe periudhës në tri vitet e fundit kapin vlerën prej 249,961.00€. Mbi këtë bazë grupi i OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit sa i për ketë kërkesës 4 tek kapaciteti teknik dhe profesional apo 9.1&9.2 e dosjes së tenderit. Projektet e përfunduara të natyrës së kontratës po i listojnë edhe në ekspertizë si në vijim; Mirëmbajtja e semaforëve nr. Kontratës 616-21-027-2-2-1 ne vlere: 50,000.00 €, e përfunduar me date 23/05/2022. Mirëmbajtja e semaforëve nr. Kontratës 616-20-2988-2-2-1” ne vlere: 50,000.00 €, e përfunduar me date 03/09/2021. Mirëmbajtja e semaforëve, inventarëve dhe pajimeveakustike për te verberit ne qytetin e Prishtinës me nr. Kontratës 616-17-111-211 ” ne vlere: 149’961.00 € e përfunduar me date 09/01/2020. Provë lista e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit e dorëzuar nga OE ankues me ofertë për anëtarin EKO INVEST, ku kemi selktuar kontratat që i përkasin periudhës se kërkesës se dosjes se tenderit dhe ato që nuk i përkasin periudhës se kërkesës se dosjes se tenderit i kemi bere me ngjyre te kuqe. Po ashtu grupi i OE- Ankues për të përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit me ofertë ka dorëzuar tek folderi i renditur me nr. 3 dorëzimi i tenderit në faqe 4 një listë të kontratave të realizuara nga natyra e kontratës nga anëtari tjetër i konzerciumit LA SAMAFORICA me gjithsej 7 projekte te realizuara me vlerë totale prej 1688120.18€. Vlen të ceket fakti se vetëm lista e kontratave të realizuara është dorëzuar në gjuhën angleze ndërsa të gjitha dëshmitë tjera janë të dorëzuara në gjuhën Italiane për anëtarin e konzerciumit LA

SAMAFORICA, mbi këtë bazë konsideroj se komisioni i vlerësimit ka vepruar në përputhje me nenin 59 para 4 i LPP-së sipas nenit 13 par. 4 i LPP-së Operatori ekonomik mund të dorëzoj ofertë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. “Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”. Provë dëshmitë e dorëzuara nga Anëtari LA SAMAFORICA në gjuhën Italiane me ofertë. Siç vërehet nga dëshmitë e bashkangjitura edhe me ekspertizë, konsideroj se komisioni i vlerësimit ka vepruar në përputhje me nenin 59 par.4 të LPP-se duke eliminuar ofertën e grupit të OE ankues si të papërgjegjshme për faktin se anëtari i grupit të gjitha dëshmitë për kërkesën e dosjes së tenderit për kontrata të realizuara i ka në gjuhën Italiane dhe po ashtu AK, këtë fakt e ka prezantuar në letrën standerde për tenderuesin eliminuar dhe në arsyeshmërin e vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Andaj në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi 1 i palës në ankesë është i paqëndrueshëm.”

Konstatimi i dytë (II) : “Lidhur me pretendimin e dytë, Eksperti Shqyrtues sqaron se AK gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit tek përshtatshmëria teknike dhe profesionale kishte paraparë Kërkesën lidhur për kontratat e realizuara si në vijim; OE duhet të këtë Baze për Prodhimin e betonit ne Pronësi apo marrëveshje për furnizim me beton. Dëshmia e kërkuar; Kopja e licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për furnizim, OE duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim. OE- Ankues për të përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit me ofertë ka dorëzuar tek folderi i renditur me nr. 4 dorëzimi i tenderit në faqe 37 licencën me nr. 633/KPMM/2018 e cila është valide deri me dt. 12.09.2023 si dhe marrëveshjen për furnizim me beton. Licenca e dorëzuar nga OE ankues, konsideroj se nuk e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se në dosje është kërkuar në mënyrë specifike që OE duhet të këtë bazë për prodhimin e batonit apo marrëveshje për furnizim me beton, dhe si dëshmi është kërkuar kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për miniera dhe minerale. Licenca e dorëzuar nga OE ankues nuk është e vlefshme për faktin se ka skaduar afati me dt. 12.09.2023 andaj konsideroj se komisioni i vlerësimit ka vepruar në përputhje me nenin 59 par 4 të LPP-se kur ka eliminuar ofertën e OE ankues pasi që nuk i ka përmbushur kërkesat e parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit si dhe ka ofertuar me çmim më të lartë se sa oferta e rekomanduar për kontratë me një diferencë prej 25,813.00€. Andaj në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi 2 i palës në ankesë është i paqëndrueshëm. Provë licenca e dorëzuar nga OE ankues me ofertë. Me tej eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimet ankimore sa i për këtë mungesës së specifikimeve teknike të ofertës së rekomanduar për kontratë, OSHP, me dt. 09.09.2023 ka marr vendimin me nr. 410/2023 në të cilin janë trajtuar në mënyrë specifike pretendimet ankimore nga eksperti teknik ku ndër tjera është konstatuar se autoriteti kontraktues ne përshkrimin teknik qe ka ngarkuar ne sistem ka cekur qe pajisjet munde te jene ekuivalente, me poshtë po japin një shembull nga. ky përshkrim për pajisjen “Inventori për furnizim me energji elektrike ose ekuivalent” Bazuar ne atë qe thamë me larte vërehet se specifikat e semaforëve qe janë kërkuar nga AK janë po thuajse te njëjta me ato te prodhuesit LA SEMAFORICA qe ka dorëzuar OE ankues deri te 5 kolona e “diametri i dritës sinjalizuese”, ndërsa specifikat te konsumi i energjisë

me drite LED dhe kursimi i energjisë krahasuar me drita inkadeshente nuk është i njëjti me specifikat e kërkuara nga AK ose është bërë ndonjë gabim teknik në përpilimin e specifikave pasi që konsumi i energjisë me dritë Led është shumë e vogël vetëm 7 Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se kam analizuar edhe letrën standarte të tenderuesit të eliminuar dhe vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim në këto dokumente vërehet se AK ka zbatuar vendimin e OSHP-se duke i bërë përmirësimet dhe sqarimet e nevojshme. Andaj në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimet e palës në ankesë sa i për ketë mungesës se përmbushjes së specifikave teknike nga ana e OE të rekomanduar për kontratë janë trajtuar në vendimin PSH; 410/23 dhe si të tilla janë të pa qëndrueshme. Si përfundim Eksperti Shqyrtues sqaron se, po ashtu marrë parasysh shkresat e lëndës dhe korrespondencat e paraqitura në këtë raport, oferta e OE ankues mund të konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4.1.26, të LPP-së, për faktin se, oferta e tij renditet e treta (3) apo e fundit për nga çmimi si OE i papërgjegjshëm (i eliminuar) sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së. Andaj edhe nëse aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-vlerësim OE i rekomanduar për kontratë rezulton i përgjegjshëm me ofertën më të lirë në raport me OE ankues.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik Bahri Asllani duhet të refuzohet si e pabazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndriçimi sinjalizues për vendkalime për siguri”, me numër të prokurimit 616-23-4210-5-1-1. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Bahri Asllani**
- Arkivës së OSHP-së: